



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Bashkim Ramosaj, Kryetar i Komunës së Deçanit Haki Shehaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Deçanit	
Cc:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme	
Nga:	Shkelqim Jakupi, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 14/03/2018 Nr.020-348
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Deçanit	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim 01.Nr.I-8 për ri-shpalljen e zonave me interes për Komunën e Deçanit
I miratuar më datë: 28/02/2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 09/03/2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Bashkim Ramosaj, gradonačelnik Opštine Dečane Haki Shehaj, predsedavajući Skupštine opštine Dečane
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini
Preko:	Ivan Todosijhević, ministar MALS-a, <i>B.F. Todosijhević</i> Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a, <i>Rozafa Ukimeraj</i>
Od:	Shkelqim Jakupi, v.d. rukovodioca zakonskog odeljejna i monitorisanje opština, MALS <i>Shkelqim Jakupi</i> Datym: 14/03/2018 Br.020-348
Predmet:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Deçanit
Vrsta akta:	Vendim i Kuvendit të Komunës

Poštovani gradonačleniče,
Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka 01.br.I-8 za ponovno objavljivanje oblasti od interesa za opštinu Dečane
Usvojena dana, 28/02/2018. godine
Predložana za razmatranje u MALS-u dana, 09/03/2018. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon rasprave sadržaja gorenavedenog akta opštine, procenjuje da je isti u saglasnosti sa zakonskim odrebama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak.

Ministarsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT / MUNICIPALITY OF DEÇANI / OPŠTINA DEÇANI

Në mbështetje të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 12 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144, dhe në bazë të nenit 21 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt 28.02.2018, merr këtë:

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLICA E KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT / MUNICIPALITY OF DEÇANI / OPŠTINA DEÇANI			
Data: 09.03.2018			
Titulli i Organizatës:	Rr / Llogara:	Shërbimi:	Vlera:
- U-	010-348		

V E N D I M

PËR RI-SHPALLJEN E ZONAVE ME INTERES PËR KOMUNËN E DEÇANIT

I.

RI-SHPALLEN zona me interes me qëllim të përfitimt publik në Komunën e Deçanit ngastrat kadastrale siç janë në vijim:

- Ngastra nr. **893** në sipërfaqe prej 0.32,95 ha me kulturë shtëpi- ndërtesë dhe oborr e cila evidentohet si Pasuri shoqërore Kooperativa bujqësore Deçan,
- Ngastra nr. **1072** në sipërfaqe prej 0.37,,30 ha me kulturë shtëpi-ndërtesë dhe oborr e cila evidentohet si Pasuri shoqërore N.N. e Hidroekonomisë-Bistrica,
- Ngastra nr. **1320** në sipërfaqe prej 0.19,51 ha me kulturë livadh i klasit të dytë e cila evidentohet si pasuri shoqërore O.P. Gjeravica Deçan,
- Ngastra nr. **876/1** në sipërfaqe prej 2.74,90 ha me kulturë oborr, dhe oborr fabrike e cila evidentohet si pasuri shoqërore O.P Gjeravica Deçan,
- Ngastra nr. **1016** në sipërfaqe prej 0.62,06 ha me kulturë shtëpi-ndërtesë dhe oborr e cila evidentohet si Pasuri shoqërore O.P. Gjeravica Deçan,
- Ngastra nr. **1321/1** në sipërfaqe prej 0.17,67 ha me kulturë livadh i klasit të dytë e cila evidentohet si Pasuri shoqërore O.P. Gjeravica Deçan,
- Ngastra nr. **1103** në sipërfaqe prej 0.15,82 ha me kulturë shtëpi oborr dhe pemishte e klasit të parë e cila evidentohet në emër të Haxhi Bozhdaraj nga Carrabregu,
- Ngastra nr. **847/1** në sipërfaqe prej 0.83,89 me kulturë ndërtesë dhe oborr e cila evidentohet si pasuri shoqërore "Kosovatrans" Pejë dhe **847/2** në sipërfaqe prej 0.04,98 ha me kulturë oborr e cila evidentohet si Pasuri shoqërore "Kosovatrans". Të gjitha në zonën kadastrale të Deçanit.
- Ngastra nr. **507/2** në sipërfaqe prej 2.41,38 ha me kulturë fabrikë dhe oborr e cila evidentohet si pasuri shoqërore FAP "Zastava" Zona kadastrale e Isniqit dhe

- Ngastra nr. **1098** në sipërfaqe prej 10.72,10 ha me kulturë mal i klasit të tretë e cila evidentohet si Pasuri shoqërore Kombinati bujqësorë "Ereniku" Zona kadastrale e Dranocit.

Shpallen zonë e interesit publik Komunal me qëllim të rregullimit të infrastrukturës rrugore në komunën e Deçanit, ngastrat: nr. 986, 987, 988, 989, në rrugën "Haki Povataj", Çertifikata UL-70505021-00083, Komuna Kadastrale Deçan, me sipërfaqe 0.02.40 ha, e evidentuar si pasuri private.

RI-SHPALLET zonë me interes me qëllim të përfitimit publik në Komunën e Deçanit ngastra kadastrale që ceket në vijim:

- Ngastra P-70505021-01073-2 në sipërfaqe prej 0.03,91 ha me kulturë-tokë e ndërtimit e cila evidentohet si Pasuri shoqërore Ndërmarrja Ndërtimore e Hidroekonomis-Bistrica në Deçan.

RI-SHPALLEN zona me interes për komunën me qëllim të përfitimit publik në komunën e Deçanit ngastrat kadastrale si në tekstin në vijim:

- Ngastrat nr. **1017** në sipërfaqe prej 0.01,57 ha me kulturë shtëpi- ndërtesë e cila evidentohet si Pasuri shoqërore O.TH.P.B Kosovodrvo Prishtinë O.P.Gjeravica Deçan, Zona kadastrale Deçan.
- Ngastra nr. **1016/1** në sipërfaqe prej 0.48,04 ha me kulturë shtëpi-ndërtese dhe oborr në sipërfaqe prej 0.48.04 ha e cila evidentohen si Pasuri shoqërore O.TH.P.B. Kosovodrvo Prishtinë O.P. Gjeravica Deçan, Zona kadastrale Deçan.
- Ngastra nr. **71, 72 dhe 73** në sipërfaqe prej 5.38.35 ha me kulturë kullosë e klasit të tretë e cila evidentohet si pasuri shoqërore kooperativa bujqësore Deçan, Zona kadastrale Hulaj.

RI-HPALLET zonë me interes për komunën me qëllim të përfitimit publik në komunën e Deçanit ngastra kadastrale nr. **538** në sipërfaqe prej 01.75,76 ha me kulturë shtëpi dhe oborr, e cila evidentohet si Pasuri shoqërore Industria e Bashkuar e tekstilit "Ermin Duraku", Zona kadastrale Deçan.

RI-SHPALLEN zona me interes me qëllim të përfitimit publik në Komunën e Deçanit ngastrat kadastrale që do të ceket në vijim:

- Çertifikata e pronës UL-70505021-00141.
- Ngastrat: P-70505021-00504-0, P-70505021-00505-0, P-70505021-00506-0, P-70505021-00507-0, P-70505021-00508-0, P-70505021-00509-0, P-70505021-00510-0, P-70505021-00511-0, P-70505021-00512-0, P-70505021-00513-0 dhe P-70505021-00514-0, në sipërfaqe prej 10.48.76 ha me kultura të ndryshme, e cila evidentohet si Pasuri shoqërore në emër të P.SH. "PUSHIMORJA E FËMIJËVE DHE TË RINJËVE PISHAT E DEÇANIT" në Deçan.
- Çertifikata e pronës UL-70505021-00140.

- Ngastra P-70505021-00538-0, me sipërfaqe prej 1.75.76 ha, me kulturë shtëpi dhe oborr e cila evidentohet si pasuri shoqërore, P.SH. INDUSTRIA E BASHKUAR E TEKSTILIT "EMIN DURAKU" në Deçan.

RI-SHPALLET parcelle me interes për komunën me qëllim të përfitimit publik në Komunën e Deçanit ngastra kadastrale nr.945 në sipërfaqe të përgjithshme prej 87 m², me kulturë Rajon ujqor 60 m² dhe tokë ndërtimore 27 m², e cila evidentohet si Pasuri Shoqërore Ndermarrja Ndërtimore e Hidroekonomis "Bistrica", Komuna Kadastrale Deçan.

II.

Bazuar në Ligjin e ri Mbi dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtëshme të Komunës me nr.04/L-144, neni 12, Komuna do t'i drejtohet Qeverisë së Kosovës me kërkesë për kthimin e këtyre pronave në pronësi të Komunës me qëllim të realizimit të interesit publik.

III.

Procedurat për zbatimin e këtij vendimi do t'i udhëheq Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë – Shërbimi pronësoro juridik KK Deçan.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës

V.

Shtojcë e këtij Vendimi do të jetë arsyeshmeria në formë të shkruar, Çertifikatat e pronësisë dhe planet e fotokopjuara.

Me Vendim njoftohen: Qeveria e Kosovës, MAPL, AKP, Drejtoria për Gjeodezi. Kadastër dhe Pronë dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.II-8

Deçan, dt.28.02.2018

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i kuvendit:
Haki Shehaj

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E DEÇANIT - OPÇINA DEÇAN - GREAT MUNICIPALITY	
Merrni nga: Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë	Numri i Postës Postale: 6838
Si i marrat: Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë	Numri i Dokumentit: 82218